# RELACION TEKNIK

## OBJEKTI:

**NGRITJA E QENDRES PWR TRAJTIMIN E KAFSHWVE TW RRUGWS**

**ADRESA: RRUGA “GJOCE”, PASURIA ME NR. 101 / 2, ZONA KADASTRALE 3541, NJËSIA ADMINISTRATIVE KATUND I RI, DURRËS.**

## BASHKIA DURRËS

PËRMBAJTJA

1.1. PËRSHKRIM I GJENDJES EKZISTUESE

1.2. PËRSHKRIM I ZONËS SË STUDIUAR

1.3. ANALIZA E PROJEKT PROPOZIMT

KONCEPTI
FUNKSIONI
TIPOLOGJIA E OBJEKTIT

1.4. PAMJA E JASHTME E GODINËS

1.5. PËRCAKTIMI I PARAMETRAVE TE ZHVILLIMIT

1.6. HAPËSIRAT E LIRA / VENDPARKIMET

1.7. INFRASTRUKTURA

## 1.1.PËRSHKRIM I GJENDJES EKZISTUESE

Realizimi i “Qëndrës së strehimit dhe trajtimit të kafshëve pa pronare” përben një prioritet nga ana e Bashkisë Durrës, duke u nisur nga numri ankesave dhe rastet e kafshimit të qytetarëve nga qentë e rrugës (qentë agresive).

Bazuar në Ligjin Nr.10 465, datë 29.9.2011 “PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” neni nr. 54 si dhe VKM 475, dt 30.07.2021 “PËR BASHKËPUNIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE ME SHËRBIMIN VETERINAR” . Kreu III “ MBIKQYRJA DHE MBAJTJA NEN KONTROLL E QENVE DHE MACEVE ENDACAKE PA PRONARË”, ngritja e një qëndre ose ambjenti për trajtimin e këtyre kafshëve endacake, do të shërbejë për kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive që paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut ose të kafshëve.

Efektet pozitive të kësaj qëndre janë të dyanshme, pasi, përvec përmirësimit të sigurisë së jetesës së njerezve, ajo do t’i japë një shans të dytë jetese të shëndetëshme të kafshëve endacake, duke i kuruar nga sëmundjet, duke i asistuar gjatë dëmtimit të ndonjë incidenti, dhe duke i rritur kështu mundësitë për adoptim.

## 1.2.PËRSHKRIM I ZONËS SË STUDIUAR

Qëndra për strehimin dhe trajtimin e kafshëve është pozicionuar në Pasurinë me Nr. 101 / 2, Zona Kadastrale 3541, Njesia Administrative Katund i Ri. Në këtë pasuri nuk ka ndërtim ekzsitues.
Pronësia ka një sipërfaqe prej 1664 $m^2$.

Pasuria me Nr. 101 / 2, kufizohet me:

- Në Veri me Pasurinë me Nr. 291
- Në Lindje me Pasurinë me Nr. 297
- Në Jug me Pasurinë me Nr. 101/3
- Në Perëndim me Pasurinë me Nr. 101/1




## 1.3. ANALIZA E PROJEKT PROPOZIMIT

### KONCEPTI

Një strukture e tillë, nga ana funksionale ka dy objektiva kryesore

- Të siguroje shëndetin dhe të garantoje mirëqënien e kafshëve të strehuar,
- Të ndikoje në rritjen e numrit të adoptimeve

### FUNKSIONI

Funksioni i dyfishtë që kryen kjo qënder i referohet:

- Trajtimit të kafsheve sipas nevojave për ndërhyrje që ata kanë, si sëmundje apo dëmtime ndaj incidenteve.
- Strehimit të kafsheve, për një periudhe të caktuar, ku duhet të sigurohet mirëqenia e tyre përgjatë gjithë kohës së qëndrimit.

### TIPOLOGJIA E OBJEKTIT:

Kjo qëndër permban:

Një strukturë të mbyllur – sipërfaqe 105 $m^2$

- Hyrje/ recepsion – 13.1 $m^2$
- Laboratore për analiza – 13.5 $m^2$
- Sallë operimi dhe ndërhyrje – 13,6 $m^2$
- Hapësirë qëndrimi pas trajtimit – 3.2 $m^2$
- Tualete – 7 $m^2$
- Dhomë shërbimi / Roje, kujdestari – 4.9 $m^2$
- Kafaze të mbyllura – 20.6 $m^2$

Një strukturë të hapur të perbashket – sipërfaqe 168 $m^2$

Kafazet e vecanta të kafsheve – sipërfaqe 194 $m^2$

Hapësirë për parkim – 112 $m^2$

Një gropë septike – 7.5 $m^2$

Një kafaz duhet të jetë i organizuar në dy zona.

- Zona 1 – është e mbyllur në tre faqe anësore të saj, gjithashtu e mbuluar nga sipër.
- Zona 2 – është e mbuluar nga sipër, ka tre faqe anësore me rrjete, njëra prej të cilave shërben për hyrjen dhe daljen e kafshëve. Lartësia maksimale shkon deri në 2.2 m.

Zona 1 dhe Zona 2 komunikojnë me njëra - tjetrën, duke i dhënë mundësi kafshëve të zgjedhin vetë ambjentin që duan të qëndrojnë.

Qëndra përmban tre tipologji të ndryshme strukturash.

- Godina e mbyllur, është realizar me sistemin konstruktiv tra- kolonë, me mbulesë me cati me tjegulla.
- Kafazet janë realizuar pjesërisht me mure, pjesërisht me rrjetë dhe me mbulesë me llamarinë.
- Struktura e hapur është realizuar me rrjetë teli, shtrim me beton, dhe e hapur nga sipër.







## 1.4. PAMJA E JASHTME E GODINËS







Godina e mbyllur është trajtuar me elmentë të thjeshtë, me mure, dritare dhe dyer që i përshtaten nevojave të godinës, duke i dhënë prioritet funksionit të vecante që ajo ka. Kafazet e hapura dhe të mbyllura janë trajtuar me rrjetë teli, dhe me mur.

## 1.5. PËRCAKTIMI I PARAMETRAVE TE ZHVILLIMIT

### PARAMETRAT E ZHVILLIMIT

Sipërfaqja e tokës në shrytëzim - 1664 $m^2$

Sipërfaqja e strukturës së mbyllur - 105 $m^2$

Sipërfaqja e kafazeve të jashtme - 194 $m^2$

Sipërfaqja e kafazit të hapur - 168 $m^2$

Sipërfaqja e gropës septike - 7.5 $m^2$

Sipërfaqe ndërtimi totale - (105 + 194 m2) 299 $m^2$

Koeficienti i shfrytëzimit - 18 %

Intensiteti i ndërtimit - 0.18

### DISTANCAT

Distanca nga VERIU - 3.67 m

Distanca nga LINDJA - 2.00 m

Distanca nga JUGU - 3.05 m

Distanca nga PERENDIMI - 16.00 m




## 1.6. HAPËSIRAT E LIRA / VENDPARKIMET

Brënda kësaj parcele janë parashikuar hapësira të lira për parkim, sistemim me gjelberim, hapësira të sistemuara me zhavorr. Struktura integrohet lehtësisht me identitetin urban, duke ruajtur karakterin natyror të zonës.

## PARAMETRAT E SISTEMIMIT

Sipërfaqe për parkim - 112 $m^2$
Numër vendparkimesh - 9 vendparkime
Sipërfaqe e shtruar me zhavorr - 408 $m^2$
Sipërfaqe e gjelbëruar - 411 $m^2$
Sipërfaqe e shtruar me asfalt - 180 $m^2$
Sipërfaqe e urës lidhëse mbi kanal - 57 $m^2$




## 1.7. INFRASTRUKTURA

Aksesi kryesor për në këtë strukturë është parashikuar në kufirin verior të pronës, nëpërmjet rrugës “Gjoce”.

Për të eleminuar shkarkimin direkt të ujerave të zeza në terren për godinën, është parashikuar që të ndërtohet nje gropë septike para shkarkimit përfundimtar të tyre, sipas detajit të paraqitur me poshtë.







Punoi:

Ing. Lorenc Facja

Ark. Bianka Madhi

Ing. Eni Turkeshi

Ing. Klodian Beqaraj

Ing. Mariglen Jahollari